

Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

DRAFT PROGRAM**DITA E PARË (ditë e plotë)****8:30 - 9:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve*Fjala hyrëse***9:00 – 9:10** Përfaqësues i KRIIK / Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë**9:10 – 9:20** Ambasadori i Zvicrës në Tiranë, SH.T. Z. Christoph GRAF**I. Paneli i Sesionit të Parë: "Demokracia shqiptare, tranzicioni dhe detyrimet në një demokraci të konsoliduar"***Tema për referencë:*

- Detyrimet e Shqipërisë për të qenë vend i Bashkimit Europian.
- Kuadri ligjor për referendimet në krahasim me standardet europiane.
- Pjesëmarrja e qytetarëve si standard për një demokraci të konsoliduar.
- Forcimi i pjesëmarrjes qytetare për një Reformë në Drejtësi efektive.
- Si mund të ndihmojë a pengojë Reforma Administrative iniciativat qytetare dhe mekanizmat për demokracinë e drejtpërdrejtë?

9:20 – 9:30 "Demokracia e drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrja e qytetarëve në qeverisje, në raport me vlerat dhe mekanizmat ligjorë të Bashkimit Europian."

SH.S. Znj. Romana VLAHUTIN, Kreu i Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri (TBC)

9:30 – 9:40 "Angazhimi qytetar, jetësor për implementimin e reformës në sistemin e drejtësisë."

SH.T. Z. Donald LU, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri (TBC)

9:40 – 09:50 *Karta e Kopenhagës dhe Demokracia e drejtpërdrejtë. Detyrimet për pjesëmarrjen e qytetarëve si mjet për të forcuar institucionet, garantuar shtetin ligjor, si dhe garanci për llogaridhënie dhe ndalimin e presionit politik ndaj institucioneve."*

SH.T. Z. Bernd BORCHARDT, Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (TBC)

09:50 – 10.00 Pyetje, Diskutime

në bashkëpunim me / in collaboration with:

Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë

Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

II. Paneli i Sesionit të Dytë: "Konteksti shqiptar – eksperiencia dhe perspektiva"

Tema për referencë:

- Situata aktuale e njoftimit dhe konsultimit publik, përfshirja dhe transparencja në procesin legjislativ.
- Historiku i konsultimit publik dhe referendumeve në Shqipëri që prej rrëzimit të diktaturës.
- Kuadri ligjor për procedurat për iniciativat qytetare; kuotat e votuesve për vlefshmërinë e referendumeve, koha e nevojshme për të mbajtur një referendum; kontrolli i firmave të mbledhura nga qytetarët.
- Cilët lloj referendumesh janë të lejueshëm dhe sa e mundur është në praktikë për të mbajtur një referendum? Referendumat lokalë, kombëtarë, kushtetues, legjislativë, abrogativë dhe fakultativë.
- Historiku i iniciativave referendare në Shqipëri dhe arsyet për mungesën e suksesit.
- Sa të përgatitur janë qytetarët shqiptarë për të qenë protagonistë në proceset legjislative?

10:00 – 10:10 "Demokracia e drejtpërdrejtë si aspiratë dhe në ndihmë të një shoqërie në tranzicion të tejzgatur."

SH.T. Z. Alfred MOISIU, Ish-President i Republikës së Shqipërisë

10:10 - 10:25 "Eksperiencat dhe pamundësia për të ushtruar demokracinë e drejtpërdrejtë – cilat janë arsyet që iniciativat publike nuk kanë qenë të suksesshme? Perceptimi i publikut për demokracinë e drejtpërdrejtë dhe referendumat. A e kanë qytetarët shqiptarë nevojën për të ushtruar demokracinë e drejtpërdrejtë dhe referendumat?"

Prof. Gjergj SINANI, Profesor në Universitetin e Tiranës

10:25 – 10:40 "Nevojat dhe shembujt e iniciativave dhe plebishiteve qytetare– Kush janë eksperiencat e iniciativave qytetare për referendume? Pse kanë dështuar nga pikëpamja organizative? Cilat janë mësimet e nxjerra? Si i ka ndihmuar apo penguar kuadri ligjor këto iniciativa?"

Z. Dorian MATLIJA, Drejtor Ekzekutiv i Res Publica

10:40 – 10:55 "Ligj shqiptar mbi referendumat: si është zhvilluar; çfarë garancish dhe të drejtash siguron; llojet e referendumeve dhe çështjeve që mund të ngrihen, procedurat?"

Znj. Kathleen IMHOLZ, Eksperte ndërkombëtare, Zyra e Avokatisë Loloçi

10:55 – 11:05 "Roli i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në traditën e nismave qytetare referendare dhe perspektivat në përmirësimin e mekanizmit ligjor."

Z. Denar BIBA, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

11:05 – 11:15 "Jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit mbi iniciativat qytetare dhe si qëndron kjo gjykatë në raport me



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

iniciativat ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Gjykatës Kushtetuese."

Dr. Valbona PAJO, Eksperte e së Drejtës Kushtetuese

11:15 – 11:25 *"Precedentët e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese për nismat qytetare referendare dhe fryma e kuadrit ligjor mbi demokracinë e drejtpërdrejtë. Sa e ndihmon ose jo kuadri ligjor zhvillimin e demokracisë së drejtpërdrejtë."*

Dr. Sokol BERBERI, Ish anëtar i Gjykatës Kushtetuese

11:25 – 11:35 *"Pozita e institucionit të Presidentit në mekanizmin e nismave qytetare referendare dhe mundësitë për fuqizimin e rolit të këtij institucioni si promotor apo në ndihmë të këtyre nismave."*

Përfaqësues i Presidencës së Republikës së Shqipërisë (TBC)

11:35 – 11:55 Pyetje, Diskutime

11:55 – 12:15 Pushim kafe

III. Paneli i Sesionit të Tretë: "Shfaqjet e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe format alternative. Demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtpërdrejtë – Konteksti ndërkombëtar"

Tema për referencë:

- Demokracia e drejtpërdrejtë përkundër demokracisë përfaqësuese, sa fuqi kanë qytetarët?
- Modelet dhe tradita europiane në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe konsultimin publik.
- Shqetësimet e demokracisë së drejtpërdrejtë nga sundimi i shumicës dhe pakicës.
- Pjesëmarrja qytetare si shërues i sëmundjeve të demokracisë.
- Demokracia e drejtpërdrejtë si një instrument në qeverisjen lokale dhe kombëtare.
- Avantazhet dhe disavantazhet e demokracisë së drejtpërdrejtë përkundër demokracisë përfaqësuese, një panoramë e traditës europiane.
- Kuadret ligjore për organizimin e referendumeve në Europë.
- Demokracia e drejtpërdrejtë nëpërmjet dinamikave të internetit dhe rrjeteve sociale.
- A është një votë e mjaftueshme si përgjigje për katër vjet qeverisje në shekullin e 21-të?

12:15 – 12:45 *"Modeli i Mbretërisë së Bashkuar për iniciativat qytetare; plebishit apo referendum; Referendumi për pavarësi i Skocisë; Brexit; shqetësimi nga sundimi i shumicës; çfarë çështjesh mund të jenë objekt referendumi; a mund të ketë një "shans të dytë" pas referendumeve?"*

Znj. Katie GHOSE, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Reformë Zgjedhore, Mbretëri e Bashkuar

12:45 – 13:05 Pyetje, Diskutime



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

13:05 – 13:35 “Modeli i Zvicrës – të qeverisësh nëpërmjet referendumeve. Kufizimet e demokracisë së drejtpërdrejtë; parimet kushtetuese dhe rreziqet nga referendumet.”

Prof. Andreas AUER, Drejtor Themelues i Qendrës për Demokraci të Drejtpërdrejtë, Profesor në Universitetin e Gjenevës, Zvicër.

13:35 – 13:55 Pyetje, Diskutime

13:55 – 15:00 Dreka

15:00 - 15:30 “Modeli i Shteteve të Bashkuara për iniciativat qytetare dhe referendumet reflekton qasje të ndryshme ndërmjet 50 shteteve. Çfarë kundërshtish janë ngritur ndaj këtyre proceseve dhe çfarë reformash janë ndërmarrë për të fuqizuar këto forma të demokracisë së drejtpërdrejtë? Si mund të ndikojë teknologjia përfshirjen e qytetarëve, përtej kutisë së votimit, përfshi E-Aktivizmin?”

Znj. Conny McCORMACK, Konsulente e administrimit zgjedhor, IFES, OSBE/ODIHR, Shtetet e Bashkuara të Amerikës

15:30 – 15:50 Pyetje, Diskutime

15:50 – 16:20 “Sfidat e demokratizimit të demokracisë që nga Iniciativa Qytetare Europiane në vendimmarrjen për çështje vendore. Si të mendosh globalisht dhe të veprosh lokalisht në një demokraci të valës së tretë të pasuksesshme?”

Z. Andreas GROSS, lic.es.sc.pol., Dr.h.c., studiues i shkencave politike, ekspert ndërkombëtar për Demokracinë e Drejtpërdrejtë, ish Deputet në Parlamentin e Zvicrës dhe President i Grupit Social-Demokrat në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (2008-2016).

16:20 – 16:40 Pyetje, Diskutime

16:40 – 17:00 Pushim kafe

IV. Paneli i Sesionit të Katërt: “Perspektivat dhe qëndrimet e partive politike në Shqipëri”

Tema për referencë:

- Reflektime të partive politike mbi nevojën për pjesëmarrjen qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës.
- Perspektiva e partive politike mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

- 17:00 – 17:10** *“Reflektimet e Partisë Socialiste mbi nevojën për pjesëmarrje qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës; perspektiva mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.”*
Përfaqësues i Partisë Socialiste (TBC)
- 17:10 – 17:20** *“Reflektimet e Partisë Demokratike mbi nevojën për pjesëmarrje qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës; perspektiva mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.”*
Përfaqësues i Partisë Demokratike (TBC)
- 17:20 – 17:30** *“Reflektimet e Lëvizjes Socialiste për Integrim mbi nevojën për pjesëmarrje qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës; perspektiva mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.”*
Përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim (TBC)
- 17:30 – 17:40** *“Reflektimet e Partisë Republikane mbi nevojën për pjesëmarrje qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës; perspektiva mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.”*
Z. Arjan MADHI, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Republikane Shqiptare
- 17:40 – 17:50** *“Reflektimet e Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet mbi nevojën për pjesëmarrje qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës; perspektiva mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.”*
Znj. Mesila DODA, Sekretare e Përgjithshme e Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet
- 17:50 – 18:00** *“Reflektimet e Partisë Fryma e Re Demokratike mbi nevojën për pjesëmarrje qytetare në procesin legjislativ dhe politikë-bërës; perspektiva mbi një ligj të ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë.”*
Znj. Valbona DURI, Nënkryetare e Partisë Fryma e Re Demokratike
- 18:00–18: 15** Pyetje, Diskutime
- 18:15 – 18:30** Konkluzione paraprake
- Mbyllja e ditës së parë.**



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

DITA E DYTË (gjysmë dite)

8:30 – 9:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

V/1. Paneli I i Sesionit të Pestë "Roli i aktorëve civilë dhe pjesëmarrja në proceset institucionale dhe qeverisëse"

Tema për referencë:

- Roli që mund të luajnë dhe presioni që mund të ushtrojnë organizatat jo-qeveritare.
- Demokracia e drejtpërdrejtë si një instrument i shoqërisë civile.
- Rëndësia e referendumeve lokale dhe aplikimi i mekanizmave të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë në qeverisjen lokale.
- Referendumet dhe grupet ekonomike të interesit.
- Përfshirja efektive e aktorëve civilë, veçanërisht burimeve akademike, në procesin politikë-bërës dhe legjislativ.
- Aktorët civilë si iniciatorë dhe palë e proceseve institucionale.

9:00 – 9:10 "Mundësitë e shoqërisë civile, grupimeve qytetare apo formave alternative të bashkimit në stimulimin e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe rëndësia e tyre në hartimin e politikave publike."

Z. Jurgen VAN MEIRVENNE, Zv. Ambasador i Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri

9:10 – 9:40 "Angazhimi socio-politik qytetar: Ç'mësime mund të nxirren nga eksperiencat e kohëve të fundit në Holandë dhe vende të tjera të Europës Perëndimore?"

Prof. Paul DEKKER, Profesor i Shoqërisë Civile në Departamentin e Sociologjisë - Universiteti i Tilburgut, Holandë

9:40 – 10:00 Pyetje, Diskutime

10:00 – 10:20 "Sfidat e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri përballë centralizimit të pushtetit qeverisës. Reforma Administrativo-Territoriale dhe pasqyrimi në iniciativat qytetare referendare për çështje vendore."

Z. Andreas GROSS, lic.es.sc.pol., Dr.h.c., studiues i shkencave politike, ekspert ndërkombëtar për Demokracinë e Drejtpërdrejtë, ish Deputet në Parlamentin e Zvicrës dhe President i Grupit Social-Demokrat në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës (2008-2016).



në bashkëpunim me / in collaboration with:



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë**



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

10:20 – 10:30 *"Roli i shoqërisë civile, veçanërisht i sferës akademike, në investimin e institucioneve dhe procesin ligjvënës."*
Znj. Albana SHTYLLA, Sekretare e Përgjithshme e Kuvendit të Shqipërisë

10:30 – 10:45 Pyetje, Diskutime

10:45 – 11:00 Pushim kafe

V/2. Paneli II i Sesionit të Pestë "Roli i aktorëve civilë dhe pjesëmarrja në proceset institucionale dhe qeverisëse"

11:00 – 11:10 *"Përvoja e Bashkisë Kuçovë në konsultimin publik dhe qeverisjen vendore. Cilat janë sfidat e përballura dhe mundësitë për përmirësim?"*
Z. Selfo KAPLLANI, Kryetar i Bashkisë Kuçovë

11:10 - 11:20 *"Sfidat e nismave qytetare ndaj kauzave ambientaliste dhe cili mund të jetë kontributi akademik. Shqetësimet e sjella nga përvoja dhe përpjekjet e deri më sotme."*
Z. Olsi NIKA, Drejtor Ekzekutiv Eco Albania

11:20- 11:30 *"Roli i shoqërisë civile në proceset referendare. Ambientalizmi si kauzë referendare dhe rasti i Lumit të Valbonës. A mundet shoqëria civile të ndërmarrë një rol specifik si promotor i nismave referendare?"*
Znj. Catherine BOHNE, Organizata TOKA

11:30 – 11:40 *"Domosdoshmëria e reagimit të aktorëve civilë në ruajtjen e integritetit dhe pavarësisë së vet; ridimensionimi i rolit të tyre në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të qytetarëve në një shoqëri të politizuar përballë sfidave të integritetit dhe ndërmarrjes së reformave."*
Znj. Elsa BALLAURI, Drejtore Ekzekutive i Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut

11:40 – 11:50 *"Sipërmarrjet private dhe Demokracia e Drejtpërdrejtë. Ku përballen dhe ku i vijnë në ndihmë njëra-tjetrës?"*
Z. Bardhi SEJDARASI, Lidhja e Gazetarëve Ekonomikë

11:50 – 12:00 *"Media si zgjatim i pushtetit dhe diktatura e informacionit. Roli i medias në formësimin e mendimit kritik dhe në mbështetje të nismave demokratike."*
Prof. As. Dr. Mark MARKU, Lektor në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës

12:00 – 12:10 Pyetje, Diskutime



në bashkëpunim me / in collaboration with:



Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë



Hotel Tirana International

Tiranë, Shqipëri / Albania

2 - 3 Shkurt / February 2017

VI. Paneli i Sesionit të Gjashtë "Konkluzionet e Konferencës"

Tema për referencë:

- Qasja e drejtuesve politikë mbi pjesëmarrjen e qytetarëve.
- Komente nga drejtuesit politikë mbi Konkluzionet e Konferencës.
- Qëndrimi dhe angazhimi i drejtuesve politikë për një ligj të ri mbi referendumet dhe mekanizma të tjerë të demokracisë së drejtpërdrejtë.
- Ligji i ri për referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë si tema kryesore e fushatës zgjedhore.

12:10 – 12:20 "Prezantimi i dokumentit konkluziv paraprak nga ligjëratat dhe diskutimet e zhvilluara."
Përfaqësues i KRIIK / Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

12:20 – 12:30 "Komente mbi konkluzionet e Konferencës, qëndrimi dhe angazhimi për një ligj të ri mbi referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë nga Partia Socialiste."
SH.T. Z. Edi RAMA, Kryetar i Këshillit të Ministrave, Kryetar i Partisë Socialiste (TBC)

12:30 – 12:40 "Komente mbi konkluzionet e Konferencës, qëndrimi dhe angazhimi për një ligj të ri mbi referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë nga Partia Demokratike."
Z. Lulzim BASHA, Kryetar i Partisë Demokratike (TBC)

12:40 – 12:50 "Komente mbi konkluzionet e Konferencës, qëndrimi dhe angazhimi për një ligj të ri mbi referendumet dhe mekanizma të tjerë për demokracinë e drejtpërdrejtë nga Lëvizja Socialiste për Integrim."
SH.T. Z. Ilir META, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, Kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim (TBC)

12:50 – 13:00 "Fjala mbyllëse"
Përfaqësues i KRIIK / Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë



në bashkëpunim me / in collaboration with:

Koalicioni i
Vëzhguesve
VendorëMbyllja e Konferencës